

QKRMT – 26 VJET KUJDES, SHPRESË DHE DREJTËSI (1999–2025)



12,000

përfitues nga
shërbimet e
drejtpërdrejta

20,000

njerëz të
mbështetur nga
puna jonë

1,400

raste të
dokumentuara të
dhunës seksuale

1999

THEMELIMI I QKRMT-së

- ✓ QKRMT udhëhoqi dhe themeloi programin e parë mbi traumën në Kosovë, duke hedhur bazat e një modeli kombëtar të rehabilitimit për të mbijetuarit.

2002

ANGAZHIMI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT E NJERIUT

- ✓ QKRMT zgjeroni përkushtimin e Kosovës ndaj të drejtave të njeriut duke ndihmuar në avancimin e Deklaratës që njeh Konventën e OKB-së kundër Torturës.

2005

STUDIMI I PARË KËRKIMOR MBI PASOJAT E LUFTËS

- ✓ Studimi i parë kërkimor mbi ndikimin afatgjatë të luftës, duke formësuar të kuptuarit e nevojave psikologjike, sociale dhe ekonomike të të mbijetuarve.

2006 – 2011

THEMELIMI I SEKTORIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE AVOKIM



- ✓ **Sektori i të drejtave të njeriut dhe avokimit** i QKRMT-së u krijua për të nxitur reformën ligjore dhe ndryshimin e politikave.
- ✓ QKRMT nisi **monitorimin e të drejtat e personave të privuar nga liria** në burgje, polici dhe institucione të shëndetit mendor e kujdesit social.
- ✓ QKRMT nisi procesin e krijimit të **Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës**, duke organizuar konferencën e parë (2009) dhe u bërë pjesë e Komitetit Drejtues (2011).
- ✓ Janë publikuar **15 Raporte Vjetore me rekomandime** nga monitorimi i burgjeve, duke rritur standardet kombëtare dhe duke u bërë reference për mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut.

2012

AVOKIM PËR NJOHJE LIGJORE

- ✓ QKRMT nisi fushatën “Dëgjo Zërin Tim”, duke siguruar **dialogun e parë midis të mbijetuarve të dhunës seksuale dhe qeverisë** për të çuar përpara njohjen e tyre ligjore.

2013–2014

NJOHJA LIGJORE DHE KORNIZA INSTITUCIONALE KOMBËTARE

- ✓ U arrit **njohja ligjore dhe të drejtat e dëmshpërblimit për të mbijetuarit e Dhunës seksuale të luftës** nëpërmjet ndryshimit të Ligjit Nr. 04/L-172 të viteve 2013–2014, duke shënuar një moment historik.

2015–2018

FORCIMI I MBËSHTETJES LIGJORE DHE NDIKIMI I AVOKIMIT

- ✓ **Feride Rushiti** nderohet nga Departamenti Amerikan i Shtetit me Çmimin Ndërkombëtar “Gratë e Guximshme.”
- ✓ Avokimi i QKRMT-së siguroi krijimin e **Komisionit Qeveritar**, një **buxhet të dedikuar shtetëror** dhe **fillimin e procesit të njohjes ligjore të të mbijetuarve të dhunës seksuale**.
- ✓ Fushata “Bëhu Zëri Im” përforcoi më tej zërat e të mbijetuarve dhe avancoi drejtësinë dhe dinjitetin.
- ✓ **Vasfije Krasniqi** u bë e mbijetua e parë që ndau publikisht përvojat e saj të dhunës seksuale gjatë luftës, duke thyer heshtjen dhe duke rritur ndërgjegjësimin kombëtar.

2019 – 2021

AVANCIMI I DREJTËSISË DHE HULUMTIMI MBI TRAUMËN

- ✓ **Shyrete Tahiri**, një e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës, **paraqiti publikisht një kallëzim penal te Prokurori i Posaçëm i Kosovës**, duke kërkuar drejtësi për krimet që përjetoi.
- ✓ QKRMT ndërtoi platformën e parë për **dokumentimin e krimeve të dhunës seksuale të luftës**.
- ✓ Rasti i parë i që dikush dënohet **për dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë**, ku QKRMT mbështeti viktimën në të gjitha fazat e procesit gjyqësor.
- ✓ QKRMT udhëhoqi **studimin e parë epigjenetik mbi traumën ndërbrezore**.

2022

- ✓ QKRMT organizoi **konferencën ndërkombëtare mbi Marrëveshjen Kosovë–Danimarkë** për dhënien me qera të Burgut të Gjilanit, duke prezantuar rekomandime dhe praktikat globale.

2023

- ✓ Pas 9 vjet përfaqësimi ligjor, **një i burgosuri e fitoi të drejtën për kompensim** për dhunën seksuale që përjetoi në Burgun e Dubravës.

2023

AVANCIMI I NJOHJES DHE TË DREJTAVE TË TË MBIJETUARVE

- ✓ **14 Prilli 2023** njihet zyrtarisht si **Ditë memoriale** për të nderuar të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe për të rritur ndërgjegjësimin kombëtar.
- ✓ Avokimi i QKRMT-së **zgjati afatin e aplikimit me 2+2 vjet**, duke u mundësuar më shumë të mbijetuarve të ushtrojnë të drejtat e tyre deri më 15 maj 2027.

2024

25-VJETORI I QKRMT-së – KONFERENCA: AVANCIMI I TË DREJTAVE, NDRYSHIMI I JETËVE

- ✓ QKRMT shënoi 25-vjetorin e saj duke organizuar një **konferencë ndërkombëtare mbi dhunën seksuale të lidhur me konfliktin**, duke bashkuar të mbijetuarit, ekspertët dhe institucionet për të nxitur drejtësinë dhe politikat që në fokus kanë të mbijetuarit.
- ✓ **Gratë e mbijetuara mbështeten** me grante të përshtatura **për të rritur pavarësinë ekonomike** dhe për të ndihmuar rimëkëmbjen psikologjike përmes bizneseve shtëpiake.
- ✓ Pas avokimit të QKRMT-së, **u miratua Ligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor**, i cili garanton **kujdes shëndetësor falas dhe pa kushte për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës**.

2025

AVANCIMI I DREJTËSISË DHE TË DREJTAVE PËR TË MBIJETUARIT

- ✓ Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli edhe 2 aktgjykime dënuese, ku **3 kryerës të dhunës seksuale të luftës u dënuam me nga 15 vjet burg**; me mbështetjen e QKRMT-së që i ofroi mbështetje të plotë ligjore dhe psikologjike të mbijetuarës, **totali i burgimeve për këto krime arrin në 58 vjet.**
- ✓ Dy aktakuza të reja për dhunë seksuale gjatë luftës u ngritën, duke e çuar totalin në 12, shumica e të cilave të dokumentuara dhe të përgatitura nga QKRMT.
- ✓ Gjykata e Apelit konfirmon rastin e parë, të përfaqësuar nga QKRMT, duke garantuar sigurimin e pensioneve të dyfishta për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.
- ✓ Mbi 50 përfitues janë përfaqësuar në gjykata (raste administrative), ku QKRMT për vetëm 5 raste ka siguruar kompensim për në vlerë mbi **61,000 €**:
 - Dy të mbijetuarve iu njoh statusi viktimë e dhunës seksuale, njëra përfitoi **24,000 €** nga viti 2018, ndërsa tjetra **13,000 €** nga viti 2021.
 - Në rastet për **pension të dyfishtë, 3 të mbijetuar** kanë fituar kompensim retroaktiv në vlerë prej gjithsej **24,600 €**
- ✓ Dhomë e sigurt e inauguruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë për të mbështetur dëshminë e të mbijetuarve, për të siguruar qasje në drejtësi dhe zvogëluar mundësitë e ritraumatizimit.

JANAR 2025

NOMINIM PËR ÇMIMIN NOBEL PËR PAQE

- ✓ QKRMT dhe Drejtorja Ekzekutive Dr. Feride Rushiti u nominuan për Çmimin Nobel për Paqe, për përkushtimin e tyre prej dekadash ndaj të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës.

14 PRILL 2025

AVOKIM PUBLIK NGA NJË I MBIJETUAR MASHKULL

- ✓ Për herë të parë, Ramadan Nishori një i mbijetuar mashkull ndau publikisht historinë e tij, duke thyer heshtjen dhe luftuar tabutë shoqërore.



NA KONTAKTONI

Rr. Hamëz Jashari, 16b/2
10 000, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 243 707
Email: info@krct.org
Web: <https://krct.org/>

DHURO

Ndihmo përfituesit tanë duke dhuruar në:
ProCredit Bank Prishtina
1110102591060197